



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Tiranë, më 21.08.2019

NJOFTIM
“PËR NGRITJEN NË DETYRË NË KLSH”

Në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”, si dhe Vendimin nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar;

Kontrolli i Lartë i Shtetit hap procedurat për ngritje në detyrë përkatësisht për:

I. Për pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm” që do të mbikqyrë Departamentin e Auditimit të Performancës, Departamentin e Auditimit të IT-së dhe Departamente të tjera auditimi nga të cilët një aktual dhe tjetri që mund të krijohet në të ardhmen si pjesë e Departamentit të Auditimit të Performancës ose i ndarë (Departamenti i Auditimeve Inovative dhe Sistemeve).

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë Drejtuesit dhe Audituesit e KLSH-së që plotësojnë këto kriterë:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH;
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në punë/auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme, etj.

Të gjithë të interesuarit duket të paraqesin kërkesën e tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore deri më **datë 05 shtator 2019**.

Kërkesa duhet të shoqërohet me një prezantim të performancës gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese dhe detyrave funksionale si dhe paraqitjen e një projekti mbi drejtimin e këtyre departamenteve.

Testimi për ngritje në detyrë do të zhvillohet bazuar në vlerësimin e performancës, vlerësimin e dosjeve individuale, si dhe intervista e strukturuar me gojë nga Komiteti i Pranimi Për Ngritjen në Detyrë.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE